

VIZION FOKUS ▶ Vrau ish-vjehrrin dhe ish-kunatin në Lezhë/ Arrestohet pas katër muajsh Besnik Pjetri



Vrau ish-vjehrrin dhe ish-kunatin në Lezhë/ Arrestohet pas katër muajsh Besnik Pjetri

0 KOMENTE

December 16, 2022



Policia ka arrestuar këtë të premte, Besnik Pjetrin.

Pjetri ekzekutoi me armë zjarri në gusht të këtij viti ish-vjehrrin dhe ish kunatin e tij të cilët sapo ishin kthyer nga Italia.

Ngjarja ndodhi në 29 gusht të këtij viti, pas një konflikti të çastit në fshatin Grykë e Zezë në Lezhë.

Autori ishte divorcuar me vajzën dhe motrën e viktimave që 6 vite më parë.

Ai ishte denoncuar nga ish-gruaja edhe më parë, për dhunë në Itali, ku edhe ka bërë 2 vite burg.

Lezhë / RENE A kap dhe vë në pranga një shtetas shumë të kërkuar për vrasje të dyfishtë me armë zjarri.
Finalizohet operacioni policor i koduar “Fundi i arratisë”, i zhvilluar në kushte të vështira terreni dhe atmosferike.
Operacioni, i finalizuar si rezultat i ndërhyrjes profesionale të shërbimeve të RENE A-s dhe punës gjurmuese-policore të strukturave hetimore dhe operacionale të Policisë së Lezhës.
Lokalizohet në një banesë të braktisur në Kaçinar, Mirditë, kapet dhe vihet në pranga 49-vjeçari i shumëkërkuar për vrasje të dyfishtë me armë zjarri.
I ndaluar vrau babanë dhe vëllanë e ish-bashkëshortes së tij, më datë 29.08.2022, në banesën e tyre, në Grykë-Zezë, Lezhë.
Shërbimet e Policisë së Lezhës, në vijim të punës intensive gjurmuese-policore, në bashkëpunim me Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për kapjen dhe vënien në pranga të autorit të shumëkërkuar të vrasjes së dyfishtë, me armë zjarri, të ndodhur më 29.08.2022, në Grykë-Zezë, Lezhë, ku u vranë shtetasit P. P., 56 vjeç dhe G. P., 32 vjeç (babai dhe vëllai i ish-bashkëshortes së autorit), mbështetur nga intelijenca informative, si dhe falë ndërhyrjes profesionale nga shërbimet e RENE A-s, organizuan dhe finalizuan operacionin policor të koduar “Fundi i arratisë”, të zhvilluar në një terren me kushte tejet të vështira gjeografike dhe atmosferike.
Si rezultat i këtij operacioni, falë kërkimeve të pandërprera dhe ndjekjes intensive, duke përdorur forma dhe teknika speciale hetimi, u bë i mundur lokalizimi në një banesë të braktisur, në fshatin Kaçinar, Mirditë, si dhe kapja e vënja në pranga e shtetasit:
– B. P. (P.), 49 vjeç, banues në Troshan, Lezhë.
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë i ka caktuar 49-vjeçarit, në mungesë, masën e sigurisë “Arrest në burg”, pasi nga veprimet hetimore, të kryera nën drejtimin e Prokurorisë së Lezhës, rezultojnë se 49-vjeçari, më datë 29.08.2022, për shkak të një konflikti me familjarët e ish-bashkëshortes së tij, ka vranë me armë zjarri shtetasit P. P. dhe G. P. (babai dhe vëllai i ish-bashkëshortes së tij).
Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për veprime të mëtejshme.



MË TË LEXUARAT



Ja cilat janë femrat që kanë nevojë urgj...




“Mjaft është mjaft”/ Kryeministri britan...



Bashkëpunoi me djalin dhe një person tje...




Tragjedia në brigjet angleze/ Autoritete...



Bashkëshorti iu vra gjatë grabitjes në R...

Posted Under: [Kronike](#) [Kryesoret](#) [Vendi](#)

Tagged: [arrest](#) [Autor](#) [Besnik pjetri](#) [Lezhe](#) [Vrasës](#)



Leave a Reply

Your email address will not be published. Required fields are marked *

Comment *

Name *

Email *

Website

☐ Save my name, email, and website in this browser for the next time I comment.

[Post Comment](#)



VIZION PLUS TV



TË TJERA NGA KRONIKE



“Porosinë e dha Marjeta”/ Zbardhen dëshmitë e autorëve të vrasjes makabre në Dajt, 56-vjeçarja ‘kyç gojën’ për lidhjen me viktimën

[më shumë...](#)


Arrestohet një serb i dyshuar për krime lufte

[më shumë...](#)




“Porosinë e dha Marjeta”/ Zbardhen dëshmitë e autorëve të vrasjes makabre në Dajt, 56-vjeçarja ‘kyç gojën’ për lidhjen me viktimën

[më shumë...](#)



Vrau ish-vjehrrin dhe ish-kunatin në Lezhë/ Arrestohet pas katër muajsh Besnik Pjetri

[më shumë...](#)



Rusia lëshon mbi 60 raketa; bombardimet lënë Kievin pa drita e energji, sulmohet edhe vendlindja e Zelenskyt

[më shumë...](#)

Kreu i ri i SPAK/ Adnan Xholi prezanton kandidaturën e tij

[më shumë...](#)



Arrestohet punonjësi i Policisë/ Qyflafi shkaktoi aksident në gjendje të dehur



[më shumë...](#)

Posta Shqiptare: 110 vite pasion, traditë dhe zhvillim

[më shumë...](#)



KARRIERA NA KONTAKTONI RRETH NESH



Aktualitet

Politike
Kronike
Ekonomi
Sociale
Kulture
Bota

Gossip

Gossip
Showbiz
Lifestyle

Inovacion

Shkencë
Teknologji

Programacion

Emisione
Seriale
Programi javor
LIVE

Partner mediatik

